



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arkivi Qendror - Centralno Arhiva - Central Archive
Nr./Br./No. 3076
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 4+4+4
Data/Datum/Date: 13.08.2024 PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.18/2024**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT**  
**ADMINISTRATIV (MBPZHR) NR. 05/2021 TË NDRYSHUAR DHE**  
**PLOTËSUAR ME UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR.08/2009 PËR**  
**CAKTIMIN E TAKSËS PËR REGJISTRIMIN E SUBJEKTEVE, TESTIM**  
**TË VARIETETEVE PËR VLERËN KULTIVUESE PRODHUESE DHE**  
**SHTYPJEN E ETIKETAVE PËR FARËRA TË DRITHËRAVE**

<sup>1</sup> Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr.18/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR. 05/2021 të ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ Nr.08/2009 për caktimin e taksës për regjistrimin e subjekteve, testim të varieteteve për vlerën kultivuese prodhuese dhe shtypjen e etiketave për farëra të drithërave, i nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datën 09.08.2024.

Në mbështetje të nenit 12 pika e) të Ligjit Nr.2003/5 i Koosvës për Farëra (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr8/15 Dhjetor 2006), duke marrë parasysh nenin 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 07, dt. 01 Mars 2019), në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 të Rregullore (QKR) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare 21.06/2024), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.18/2024**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MBPZHR)**  
**- NR. 05/2021 TË NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME UDHËZIMIN**  
**ADMINISTRATIV NR.08/2009 PËR CAKTIMIN E TAKSËS PËR REGJISTRIMIN E**  
**SUBJEKTEVE, TESTIM TË VARIETETEVE PËR VLERËN KULTIVUESE**  
**PRODHUESE DHE SHYTPJEN E ETIKETAVE PËR FARËRA TË DRITHËRAVE**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR. 05/2021 të ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ Nr.08/2009 për caktimin e taksës për regjistrimin e subjekteve, testim të varieteteve për vlerën kultivuese prodhuese dhe shlypjen e etiketave për farëra të drithërave, me qëllim të krijimit të bazës ligjore për zbatimin e akteve nënligjore nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari që i përcaktojnë autoritetin licencues për farëra.

**Neni 2**

Në nenin 2 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjalia “Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje” zëvendësohet me fjalinë “Agjencia për Ushqim dhe Veterinari”.

**Neni 3**

Neni 3 i Udhëzimit Administrativ 05/2021 fshihet dhe riformulohet në tërësi si në vijim:

**Neni 3**

**Procedura dhe kushtet e licencimi për importues, prodhues, përpunues, paketues dhe tregtues i farërave**

1. Personat që merren me importim, prodhim, përpunim, paketim dhe tregtim të farërave duhet të licencohen në pajtim me rregullat e përcaktuara në ligjin për farërat dhe rregullat e këtij udhëzimi administrativ.

2. Për licencimin sipas paragrafit 1 duhet të paraqitet kërkesa në pajtim me dispozitat e Ligjit përkatës për procedurën e përgjithshme administrative (në vijim: LPPA).

3. Për licencimin e personave që merren me importimin, prodhimin, përpunimin, paketimin dhe tregtimin e farërave duhet të plotësohen kushtet dhe kriteret si në vijim:

3.1. Për personat juridik, informatën se janë të regjistruar si biznes në regjistrin përkatës të bizneseve;

3.2. Të ketë diplomë universitare ose të ketë të punësuar personin me diplomë universitare-drejtimi përkatës për subjektet që aplikojnë për licencim prodhim, importim dhe paketim të farërave;

3.3. Të ketë diplomë shkollës së mesme ose të ketë të punësuar personin me shkollë të mesme-drejtimi lavërtari, prodhimtari bimore për subjektet që aplikojnë për licencim për tregtim;

3.4. Procesverbalin e inspektorit fitosanitar që dëshmon se posedon objektin i cili i plotëson kriteret përkatëse për deponim, ruajtje dhe tregtimin e farës të përcaktuara në nenin 4 të këtij Udhëzimit Administrativ;

4. Për licencimin e personave të cilët merren me importimin, prodhimin, përpunimin, paketimin dhe tregtimin e farërave zhvillohet procedura në pajtim me LPPA

5. Për licencimin e personave të cilët merren me importimin, prodhimin, përpunimin, paketimin dhe tregtimin e farërave nga organi licencues lëshohet certifikatë e cila përmban:

5.1. emrin dhe logon e autoritetit licencues;

5.2. numrin identifikues të certifikatës dhe datën e lëshimit;

5.3. të dhënat e personit të licencuar;

5.4. llojin e farërave për të cilin bëhet licencimi;

5.5. lloji i veprimtarisë me të cilën ka të bëjë licencimi;

5.6. vendi i veprimtarisë, nëse ka;

5.7. nënshkrimi i personit të autorizuar për të nënshkruar në emër të autoritetit licencues.

Nënshkrimi bëhet në pajtim me rregullat e përcaktuara në ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.

6. Në sistemin elektronik krijohet certifikata elektronike e cila përmban të gjitha elementet sipas paragrafit 5 të këtij neni dhe ka vlerën e njëjtë si certifikata fizike e cila mund të shkarkohet nga personi në çdo kohë përmes sistemit elektronik.

#### **Neni 4**

Neni 5 paragrafi 3 i të Udhëzimit Administrativ Nr.08/2009 bazik, fshihet.

#### **Neni 5**

Neni 6 dhe 7 i Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

#### **Neni 6**

Neni 5 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje” zëvendësohet me fjalën “Agjencia për Ushqim dhe Veterinari”, ndërsa fjalia “ Kohëzgjatja e licencës së lëshuar nga Autoriteti licencues është tre (3) vite” fshihet.

#### **Neni 7**

#### **Hyrja ne fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**Faton PEÇI**  
  
PRISHTINE 13 / 08 / 2024

